## ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

*Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092*

Një ankesë kundër: : **KOMUNA E GJAKOVËS**

Nr i Prokurimit **632-26-4696-2-1-1**

Sa i përket tenderit për **Mbikëqyrja e Projekteve**

# ANKESË

**1. Identifikimi i ankuesit***

***"P.M.N."SH.P.K & N.P.N. "UNIVERS-MI"***
*(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)*

***Agron Rrahmani, Lok.I, Nr.14, Prishtinë***
*(Adresa)*

***Prishtine*** ***10000***

*(Vendi)* *(Kodi postar)*

*+383 44 238-511*
*(Numri Telefonit)* *(Numri*

***ZENUN TOLAJ***

*(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)*

pmn.shpk2@gmail.com

*(Adresa elektronike)*

***17.11.2026***
*(Data e parashtrimit të ankesës)* *(Nënshkrimi dhe vula)*

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

**2. Identifikimi i avokatit**

*Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.*

*Shëno të dhënat si në vijim:*

_____

*(Emri i avokatit)*

_____

*(Adresa e plotë)*

_____ _____

*(Numri i Telefonit)* *(Numri i faks-it)*

_____

*(Adresa elektronike)*

_____ _____

*(Data e parashtrimit të ankesës)* *(Nënshkrimi dhe vula)*

**3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit**

*[Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës","Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimi për anulim te aktivitetit te prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:*

Ky aktivitet i prokurimit ka të bëjë me tenderin me titull **"Mbikëqyrja e Projekteve"**, me numër të prokurimit **632-26-4696-2-1-1**, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues – Komuna e Gjakovës.

Njoftimi për Kontratë është publikuar më **19.06.2026**, ndërsa hapja publike e ofertave është realizuar më **13.07.2026**.

Pas përfundimit të procesit të vlerësimit të ofertave, Autoriteti Kontraktues, më **31.07.2026**, ka publikuar Njoftimin mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues (formulari B58). Në të njëjtën datë, Grupit të Operatorëve Ekonomikë **P.M.N. SH.P.K. & N.P.N. UNIVERS-MI** i është dërguar edhe letra standarde për tenderuesin e eliminuar, përmes së cilës është njoftuar për eliminimin nga ky aktivitet i prokurimit.

**Kriteri për dhënien e kontratës** ka qenë: **"Tenderi i përgjegjshëm me çmimin më të ulët".**

Pas kundërshtimit të këtij vendimi, Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP), me Vendimin nr. **2026/0613, datë 29.09.2026**, ka aprovuar si të bazuar ankesën e operatorit ekonomik P.M.N. SH.P.K., ka anuluar Njoftimin mbi Vendimin B58 dhe e ka kthyer aktivitetin e prokurimit në rivlerësim.

Megjithatë, pas zhvillimit të procedurës së rivlerësimit, Autoriteti Kontraktues, më **09.11.2026**, ka publikuar një Njoftim të ri mbi Vendimin B58, përmes të cilit ka rekomanduar përsëri për kontratë operatorin ekonomik **AL Engineering SH.P.K.**, me vlerë të ofertës prej **115,500.00 €**, ndërsa Grupin e Operatorëve Ekonomikë **P.M.N. SH.P.K. & N.P.N. UNIVERS-MI**, me ofertë prej **89,400.00 €**, e ka eliminuar përsëri.

Përmes kësaj kërkese për rishqyrtim, kundërshtojmë ligjshmërinë e vendimit të ri të Autoritetit Kontraktues, duke konsideruar se gjatë rivlerësimit nuk janë trajtuar në mënyrë të duhur konstatimet relevante të Vendimit të OSHP-së nr. 2026/0613, si dhe janë përsëritur arsyet e eliminimit të cilat kanë qenë objekt i shqyrtimit në procedurën paraprake ankimore.

**4. Procesi i Hapjes së tenderëve,** *nëse aplikohet*

*A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.*

**Po** ☐ **Jo** ☒ x

Hapja eshte bere ne platformën eprokurimi

**5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve,** *nëse aplikohet*

*A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?*

**Po** ☒ x **Jo** ☐

**6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve**

*A keni bërë kërkese për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?*

**Po** ☒ x **Jo** ☐

Me datën **13.11.2026** kemi parashtruar **Kërkesë për Rishqyrtim** kundër Njoftimit mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues për dhënie të kontratës, të publikuar me datën **09.11.2026**, për aktivitetin e prokurimit **"Mbikëqyrja e Projekteve"**, me nr. të prokurimit **632-26-4696-2-1-1**.

Autoriteti Kontraktues ka shqyrtuar kërkesën tonë për rishqyrtim dhe me datën **16.11.2026** ka nxjerrë Vendimin, përmes të cilit ka **refuzuar si të pabazuara pretendimet tona**, ka lënë në fuqi Njoftimin mbi Vendimin e AK-së të datës **09.11.2026** dhe ka vendosur që aktiviteti i prokurimit të vazhdojë.

Duke mos u pajtuar me konstatimet dhe arsyetimin e Autoritetit Kontraktues të paraqitura në Vendimin e datës **16.11.2026**, dhe duke konsideruar se pretendimet tona nuk janë trajtuar në mënyrë të drejtë, të plotë dhe në përputhje me kërkesat e LPP-së dhe legjislacionit sekondar të prokurimit publik, **në përputhje me LPP-në dhe brenda afatit ligjor, i drejtohemi Organit Shqyrtues të Prokurimit – OSHP me këtë ankesë kundër Vendimit të Autoritetit Kontraktues të datës 16.11.2026**, duke kërkuar shqyrtimin e ligjshmërisë së vendimit të kontestuar dhe të pretendimeve tona ankimore.

**7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues**

*Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.*

AK gjate vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve nuk ka zbatuar me përpikëri të gjitha dispozitat e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092. Përpos kësaj AK nuk ka respektuar as kërkesat e dosjes së tenderit të cilat vetë i ka parashtruar në fillim të këtij procesi të prokurimit. Dispozitat që ne mendojmë se AK i ka shkelur janë:

## Dispozitat e LPP-së

- Neni 1 i LPP-së – Qëllimi;
- Neni 7 i LPP-së – Barazia në trajtim dhe jodiskriminimi;
- Neni 59 i LPP-së – Ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve;
- Neni 59.4 i LPP-së – Përgjegjshmëria e tenderit;
- Neni 69 i LPP-së – Aftësia teknike dhe/ose profesionale;
- Neni 72 i LPP-së – Dokumentacioni dhe informacioni shtesë;
- Neni 38 i Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, për aq sa zbatohet në rastin konkret;
- **Vendimi i OSHP-së nr. 2026/0613**, datë 29.09.2026, dhe detyrimi për zbatimin e tij.

Kërkohet gjithashtu shqyrtimi i mosrespektimit eventual të vendimit të OSHP-së, në kuptim të nenit 131 të LPP-së.

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kane qenë te rrejshme ose mashtruese.*

**8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet**

*Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.*

## Rrethanat procedurale pas Vendimit të OSHP-së nr. 2026/0613 dhe rivlerësimit të aktivitetit të prokurimit

Me Vendimin nr. **2026/0613, të datës 29.09.2026**, Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) ka aprovuar si të bazuar ankesën e Operatorit Ekonomik **P.M.N. SH.P.K.**, ka anuluar Njoftimin mbi Vendimin B58 të Autoritetit Kontraktues – Komuna e Gjakovës dhe ka kthyer në rivlerësim aktivitetin e prokurimit **"Mbikëqyrja e Projekteve"**, me numër **632-26-4696-2-1-1**.

Në arsyetimin e këtij vendimi, Paneli Shqyrtues i OSHP-së i ka dhënë besim të plotë konstatimeve të ekspertit shqyrtues dhe ka konstatuar se Autoriteti Kontraktues nuk kishte vepruar në përputhje me dispozitat përkatëse të Ligjit për Prokurimin Publik.

Pas kthimit të aktivitetit të prokurimit në rivlerësim, Autoriteti Kontraktues, më **09.11.2026**, ka publikuar Njoftimin e ri mbi Vendimin B58, përmes të cilit ka rekomanduar përsëri për kontratë operatorin ekonomik **AL-Engineering SH.P.K.**, me vlerë të ofertës prej **115,500.00 euro**, ndërsa Grupin e Operatorëve Ekonomikë **P.M.N. SH.P.K. & N.P.N. UNIVERS-MI**, me vlerë të ofertës prej **89,400.00 euro**, e ka eliminuar përsëri nga ky aktivitet i prokurimit.

Në të njëjtën datë, më **09.11.2026**, grupit tonë i është dërguar edhe letra standarde për tenderuesin e eliminuar, në të cilën Autoriteti Kontraktues ka paraqitur arsyet e eliminimit pas rivlerësimit.

Nga shqyrtimi i letrës së eliminimit konstatojmë se Autoriteti Kontraktues ka përsëritur arsyet e eliminimit lidhur me përvojën profesionale të stafit dhe dokumentacionin e pajisjeve teknike, të cilat kanë qenë objekt i shqyrtimit në procedurën paraprake ankimore pranë OSHP-së.

Në veçanti, Autoriteti Kontraktues ka përsëritur konstatimet për mungesën e pretenduar të përvojës profesionale të arkitektit **Driton Kabashi**, inxhinierit elektrik **Lulzim Halitaj** dhe inxhinierëve të gjeodezisë **Luan Abazi** dhe **Agron Shabani**, si dhe konstatimet për mungesën e dëshmive të pajisjeve teknike të përcaktuara në Dosjen e Tenderit.

Theksojmë se këto arsye eliminimi janë shqyrtuar në mënyrë individuale nga eksperti shqyrtues në kuadër të lëndës nr. 2026/0613, ku pretendimet tona lidhur me këto çështje janë vlerësuar si të bazuara në analizat përkatëse.

Për më tepër, Paneli Shqyrtues i OSHP-së, në arsyetimin e vendimit të tij, i ka dhënë besim të plotë konstatimeve të ekspertit shqyrtues, duke aprovuar ankesën tonë si të bazuar dhe duke urdhëruar kthimin e aktivitetit në rivlerësim.

Megjithatë, në rivlerësimin e datës **09.11.2026**, Autoriteti Kontraktues ka arritur përsëri në përfundimin për eliminimin e grupit tonë, pa dhënë arsyetim të mjaftueshëm se përse ka mbajtur qëndrime të kundërta me konstatimet individuale të ekspertit shqyrtues, të cilave Paneli Shqyrtues u ka dhënë besim të plotë.

Konsiderojmë se një veprim i tillë ngre dyshime serioze për respektimin e Vendimit të OSHP-së nr. 2026/0613 dhe për ligjshmërinë e procesit të rivlerësimit, veçanërisht në raport me nenet 59, 69 dhe 72 të LPP-së.

Gjithashtu, duke marrë parasysh se kriteri për dhënien e kontratës ka qenë **"Tenderi i përgjegjshëm me çmimin më të ulët"**, theksojmë se oferta jonë është **26,100.00 euro më e ulët** se oferta e operatorit të rekomanduar për kontratë. Nëse konfirmohet se oferta jonë është e përgjegjshme, eliminimi i saj i pajustifikuar do të cenonte edhe parimin e përdorimit ekonomik dhe efikas të fondeve publike.

**Për këto arsye, konsiderojmë se Njoftimi mbi Vendimin B58 i datës 09.11.2026 është i kontestueshëm në aspektin e ligjshmërisë dhe përputhshmërisë me Vendimin e OSHP-së nr. 2026/0613.**

Në vijim do të paraqesim dhe argumentojmë në mënyrë të veçantë secilin pretendim ankimor, duke ballafaquar arsyet e eliminimit të përsëritura nga Autoriteti Kontraktues me konstatimet përkatëse të ekspertit shqyrtues dhe arsyetimin e Panelit Shqyrtues të OSHP-së.

## PRETENDIMI NR. 1

**– Mosrespektimi i konstatimeve dhe urdhërimeve të Vendimit të OSHP-së nr. 2026/0613 gjatë rivlerësimit**

Autoriteti Kontraktues – Komuna e Gjakovës, me rastin e rivlerësimit të aktivitetit të prokurimit "Mbikëqyrja e Projekteve", ka nxjerrë Njoftimin mbi Vendimin B58, datë 09.11.2026, përmes të cilit ka eliminuar përsëri Grupin e Operatorëve Ekonomikë P.M.N. SH.P.K. & N.P.N. UNIVERS-MI.

Konsiderojmë se rivlerësimi është realizuar në kundërshtim me konstatimet relevante të Vendimit të OSHP-së nr. 2026/0613, datë 29.09.2026, përmes të cilit ankesa jonë ishte aprovuar si e bazuar, vendimi paraprak i AK-së ishte anuluar dhe procedura ishte kthyer në rivlerësim.

Në faqen 48 të vendimit, Paneli Shqyrtues ka konstatuar:

"Paneli Shqyrtues [...] ja fal besimin e plotë konstatimeve të ekspertit shqyrtues"

Gjithashtu, Paneli ka konstatuar se AK nuk ka respektuar dispozitat ligjore të LPP-së dhe e ka urdhëruar atë që gjatë rivlerësimit t'u përmbahet në tërësi dispozitave ligjore.

Në raportin e ekspertit, pjesë e vendimit të OSHP-së, janë shqyrtuar individualisht pretendimet lidhur me arkitektin Driton Kabashi, inxhinierin elektrik Lulzim Halitaj, gjeodetët Luan Abazi dhe Agron Shabani, si dhe pajisjet nr. 1, 2, 4, 5 dhe 7.

Eksperti shqyrtues, në analizat individuale të këtyre pretendimeve, ka konstatuar se pretendimet tona ishin të bazuara dhe se eliminimet mbi këto arsye nuk ishin të qëndrueshme.

Pavarësisht kësaj, AK, në rivlerësimin e datës 09.11.2026, ka përdorur përsëri të njëjtat kategori arsyesh eliminimi, duke kontestuar përvojën profesionale të të njëjtëve profesionistë dhe dëshmitë për të njëjtat pajisje.

Në letrën e eliminimit, AK nuk ka shpjeguar në mënyrë të mjaftueshme se përse ka arritur në përfundime të kundërta me analizat individuale të ekspertit, të cilave Paneli Shqyrtues u ka dhënë besim të plotë.

Kjo është veçanërisht shqetësuese pasi AK nuk ka identifikuar në këtë njoftim fakte të reja vendimtare që do të arsyetonin përsëritjen e eliminimit.

Konsiderojmë se një rivlerësim i ligjshëm duhet të përmbajë ekzaminim objektiv të ofertës dhe trajtim të argumentuar të konstatimeve relevante të vendimit paraprak të OSHP-së.

**Kërkojmë** që ky pretendim të aprovohet si i bazuar, të anulohet Njoftimi mbi Vendimin B58 i datës 09.11.2026 dhe të bëhet rivlerësimi në përputhje me Vendimin e OSHP-së nr. 2026/0613 dhe dispozitat e LPP-së. Gjithashtu, kërkojmë të shqyrtohet çështja e mosrespektimit eventual të vendimit në kuptim të nenit 131 të LPP-së.

**Kërkojmë** të aprovohet ky pretendim si i bazuar

## PRETENDIMI NR. 2

**– Eliminimi i përsëritur për arkitektin Driton Kabashi, në kundërshtim me konstatimin e ekspertit të pranuar nga Paneli Shqyrtues**

### Arsyeja e eliminimit nga AK

Në letrën e eliminimit të datës 09.11.2026, AK ka konstatuar se arkitekti Driton Kabashi nuk e ka dëshmuar përvojën minimale pesëvjeçare pas diplomimit në projekte të ngjashme.

AK ka mbështetur këtë përfundim në interpretimin e përmbajtjes së CV-së, periudhës së angazhimit profesional dhe referencës së lëshuar nga NN “Kabashi”.

### Konstatimi i ekspertit shqyrtues

Në faqen 38 të Vendimit të OSHP-së nr. 2026/0613, eksperti shqyrtues ka analizuar pikërisht këtë arsye eliminimi.

Eksperti ka konstatuar se Driton Kabashi posedon diplomë Master në Arkitekturë me 303 ECTS, të përfunduar më 28.06.2018, Licencë A nr. A-0192, CV profesionale dhe kontratë mbi vepër të datës 03.07.2026.

Në CV është paraqitur angazhimi profesional nga viti 2015 e deri në kohën e ofertimit, ndërsa dokumentet plotësuese përfshijnë referenca për angazhime në projektim dhe mbikëqyrje.

Eksperti ka konstatuar shprehimisht:

"dokumentiacioni i paraqitur është i mjaftueshëm për të konstatuar përmbushjen e kërkesës për minimum 5 vite përvojë pune pas diplomimit."

Gjithashtu, eksperti ka vlerësuar se ndryshimi ndërmjet datës së paraqitur në CV dhe asaj në një referencë nuk përbën bazë të mjaftueshme për eliminim, veçanërisht kur referencat nuk janë përcaktuar si dëshmi kryesore në Dosjen e Tenderit.

Në përfundim, eksperti e ka vlerësuar Pretendimin nr. 3 si **të bazuar**, duke konstatuar se dokumentet e dorëzuara dëshmojnë përmbushjen e kërkesave për kualifikimin dhe përvojën profesionale të arkitektit.

## Kundërshtimi i rivlerësimit

Pavarësisht këtij konstatimi, AK e ka eliminuar përsëri grupin tonë për të njëjtin profesionist, duke u mbështetur përsëri në mungesën e pretenduar të përvojës dhe në referencën e NN "Kabashi".

Konsiderojmë se AK nuk ka dhënë arsyetim të mjaftueshëm për të kundërshtuar konstatimin specifik të ekspertit, të cilit Paneli Shqyrtues i ka dhënë besim të plotë.

AK ka trajtuar përsëri referencat si bazë vendimtare të eliminimit, ndonëse eksperti kishte konstatuar se këto nuk përbënin dëshmi kryesore të kërkuara nga DT-ja.

Nëse AK kishte paqartësi lidhur me periudhat e angazhimit profesional, ato duhej të trajtoheshin në kuadër të ekzaminimit të dokumenteve dhe mundësisë së sqarimit sipas nenit 72 të LPP-së, pa ndryshuar përmbajtjen materiale të ofertës.

**Kërkojmë** të aprovohet ky pretendim si i bazuar, të anulohet arsyeja e eliminimit për Driton Kabashin dhe gjatë rivlerësimit të respektohet konstatimi i ekspertit shqyrtues në faqen 38 të Vendimit nr. 2026/0613, i marrë në konsideratë dhe i pranuar nga Paneli Shqyrtues në faqen 48.

## PRETENDIMI NR. 3

**– Eliminimi i përsëritur për inxhinierin elektrik Lulzim Halitaj**

## Arsyeja e eliminimit nga AK

AK ka konstatuar se inxhinieri elektrik Lulzim Halitaj nuk e dëshmon minimumin prej pesë viteve përvojë pune pas diplomimit në projekte të ngjashme.

Në arsyetimin e eliminimit, AK ka vënë në dyshim përputhjen e CV-së me referencat e EUROING dhe Syla Group, si dhe natyrën e përvojës profesionale të paraqitur.

## Konstatimi i ekspertit shqyrtues

Në faqet 39–40 të Vendimit nr. 2026/0613, eksperti shqyrtues ka analizuar dokumentacionin për Lulzim Halitajn.

Eksperti ka konstatuar se profesionisti posedon Master në Inxhinieri Elektrike – Elektroenergjetikë, të përfunduar më 04.05.2018, Licencë A nr. E-0042, CV profesionale dhe kontratë mbi vepër për aktivitetin konkret.

Në CV është paraqitur angazhimi në EUROING nga viti 2018 dhe në vazhdim, si dhe përvojë në projektim, monitorim, menaxhim dhe mbikëqyrje të projekteve.

Eksperti ka marrë parasysh edhe Listën e Projekteve të Menaxhuara 2018–2025, duke vlerësuar se ajo konkretizon përvojën e deklaruar në CV.

Në faqen 40, eksperti ka konstatuar:

"z. Lulzim Halitaj i përmbush kërkesat e Dosjes së Tenderit për kualifikimin profesional dhe minimumin prej 5 viteve përvojë pune pas diplomimit në projekte të ngjashme."

Eksperti ka konstatuar gjithashtu se mospërputhjet në referencat profesionale, përfshirë gabimin në emër në referencën e EUROING-ut, nuk e mohojnë vetvetiu përvojën e paraqitur në CV.

Pretendimi nr. 4 është vlerësuar si **i bazuar**.

## Kundërshtimi i rivlerësimit

AK, në rivlerësimin e datës 09.11.2026, ka përdorur përsëri mospërputhjet e referencave dhe interpretimin e natyrës së përvojës si arsye eliminimi.

Kjo është e njëjta çështje faktike dhe profesionale që eksperti shqyrtues e ka trajtuar gjatë procedurës së mëparshme ankimore.

AK nuk ka argumentuar mjaftueshëm se përse dokumentet e shqyrtuara nga eksperti tani duhet të vlerësohen në mënyrë të kundërt, përkundër konstatimit të qartë për përmbushjen e kriterit.

Gjithashtu, konsiderojmë se AK ka zbatuar interpretim tepër kufizues të shprehjes “projekte të ngjashme”, duke mos e marrë në konsideratë në mënyrë të plotë përvojën në projektim, monitorim, menaxhim dhe mbikëqyrje.

**Kërkojmë** të anulohet arsyeja e eliminimit për Lulzim Halitajn dhe të respektohet analiza e ekspertit në faqet 39–40 të Vendimit nr. 2026/0613, të cilës Paneli Shqyrtues i ka dhënë besim të plotë.

**Kërkojmë** të aprovohet ky pretendim si i bazuar.

## PRETENDIMI NR. 4

**– Eliminimi i përsëritur për inxhinierin e gjeodezisë Luan Abazi**

## Arsyeja e eliminimit nga AK

AK ka konstatuar se Luan Abazi nuk e dëshmon përvojën minimale prej pesë viteve pas diplomimit në projekte të ngjashme, përkatësisht në mbikëqyrje të projekteve.

## Konstatimi i ekspertit shqyrtues

Në faqet 40–41 të Vendimit nr. 2026/0613, eksperti shqyrtues ka shqyrtuar dokumentacionin e paraqitur për Luan Abazin.

Eksperti ka konstatuar se ai posedon diplomë Master Profesional në Inxhinieri Gjeodezi, të lëshuar më 18.02.2014, Licencë nr. 129 nga Agjencia Kadastrale e Kosovës, CV profesionale dhe kontratë mbi vepër.

Nga CV-ja rezulton angazhimi profesional nga janari 2013 dhe në vazhdim, përfshirë matje gjeodezike, piketime, mbikëqyrje profesionale, matje me GPS/TCR dhe projekte infrastrukturore.

Në dokumentacion është evidentuar edhe përvoja në aktivitetin “Mbikëqyrja e projekteve investive Lot 1 / Pjesa 1”.

Eksperti ka konstatuar shprehimisht se:

"konstatimi i Autoritetit Kontraktues se z. Luan Abazi nuk e dëshmon përvojën e kërkuar nuk përputhet me përmbajtjen e dokumentacionit të dorëzuar."

Eksperti ka vlerësuar se përvoja e dokumentuar e tejkalon minimumin e kërkuar, edhe nëse zbatohet kushti i përgjithshëm për pesë vite pas diplomimit.

## Kundërshtimi i rivlerësimit

Në rivlerësimin e datës 09.11.2026, AK ka eliminuar përsëri grupin tonë për mungesën e pretenduar të përvojës së Luan Abazit.

Konsiderojmë se AK ka përsëritur një përfundim të kundërt me konstatimin e ekspertit, pa identifikuar fakte të reja vendimtare ose pa dhënë arsyetim të mjaftueshëm për një përfundim të tillë.

Për më tepër, në kërkesën specifike të DT-së për këtë pozitë nuk ishte përcaktuar shprehimisht minimumi pesëvjeçar, ndërsa eksperti ka konstatuar se, edhe nëse ky kusht zbatohet, dokumentacioni dëshmon përmbushjen e tij.

AK nuk mund të interpretojë kërkesat e publikuara në mënyrë më kufizuese gjatë fazës së rivlerësimit.

**Kërkojmë** të anulohet arsyeja e eliminimit për Luan Abazin dhe dokumentacioni të vlerësohet në përputhje me analizën e ekspertit në faqet 40–41 të vendimit të OSHP-së dhe konstatimet e Panelit Shqyrtues në faqen 48.

**Kërkojmë** të aprovohet ky pretendim si i bazuar.

## PRETENDIMI NR. 5

**– Eliminimi i përsëritur për inxhinierin e gjeodezisë Agron Shabani**

### Arsyeja e eliminimit nga AK

AK ka konstatuar se Agron Shabani nuk e dëshmon minimumin prej pesë viteve përvojë pune pas diplomimit në projekte të ngjashme, duke u mbështetur në interpretimin e CV-së dhe dokumentacionit të paraqitur.

### Konstatimi i ekspertit shqyrtues

Në faqet 41–43 të Vendimit nr. 2026/0613, eksperti shqyrtues ka analizuar dokumentacionin e Agron Shabanit.

Eksperti ka konstatuar se ai ka përfunduar studimet në Gjeodezi më 27.07.2011 dhe ka paraqitur dokumentacion për angazhim profesional nga viti 2013 në vazhdim.

Në veçanti, referenca e N.SH. "GEO-MAP" konfirmon angazhimin e tij nga 01.09.2013 si udhëheqës dhe mbikëqyrës i punëve gjeodezike dhe kadastrale.

Gjithashtu, dokumentet e Pro&Co Group përshkruajnë përvojën e tij në projekte të ujësjellësit, kanalizimit, rrugëve dhe urave.

Në faqen 43, eksperti shqyrtues ka konstatuar se:

"Pretendimi nr. 6 është i bazuar."

Eksperti ka shpjeguar se dokumentacioni dëshmon përvojë në projekte të ngjashme dhe se AK kishte interpretuar në mënyrë tepër të kufizuar përvojën e kërkuar.

Gjithashtu, eksperti ka vënë në dukje se kërkesa specifike për këtë pozitë nuk e përcaktonte shprehimisht periudhën pesëvjeçare, ndërsa dokumentacioni i profesionistit e përmbushte atë edhe nëse do të konsiderohej e zbatueshme.

### Kundërshtimi i rivlerësimit

AK ka eliminuar përsëri grupin tonë duke pretenduar mungesën e përvojës profesionale të Agron Shabanit.

Ky përfundim është në kundërshtim me analizën individuale të ekspertit shqyrtues, i cili kishte identifikuar angazhimet konkrete në projekte gjeodezike, infrastrukturore dhe mbikëqyrje.

Konsiderojmë se AK nuk ka trajtuar në mënyrë të arsyetuar konstatimet për angazhimin në GEO-MAP, përmbajtjen e referencave dhe dallimin ndërmjet projekteve të ngjashme dhe projekteve identike.

**Kërkojmë** të anulohet arsyeja e eliminimit për Agron Shabanin dhe rivlerësimi të mbështetet në kërkesat reale të DT-së dhe konstatimet e ekspertit në faqet 41–43 të Vendimit nr. 2026/0613.

**Kërkojmë** të aprovohet ky pretendim si i bazuar.

## PRETENDIMI NR. 6

**– Eliminimi i përsëritur për pajisjen nr. 1, Instrumenti GPS për matje gjeodezike**

### Arsyeja e eliminimit nga AK

AK ka konstatuar se mungon dëshmia se instrumenti GPS është i kalibruar dhe në gjendje të rregullt teknike.

### Konstatimi i ekspertit shqyrtues

Në faqet 43–44 të Vendimit nr. 2026/0613, eksperti shqyrtues ka analizuar dokumentacionin e pajisjes nr. 1.

Eksperti ka konstatuar se është dorëzuar marrëveshja për shfrytëzimin e pajisjeve ndërmjet P.M.N. SH.P.K. dhe GeoMetri SH.P.K., datë 07.07.2026.

Në marrëveshje, pajisja është identifikuar shprehimisht si instrument GPS për matje gjeodezike, me përshkrimin që kërkon kalibrim dhe gjendje të rregullt teknike.

Eksperti ka konstatuar se në pjesën e dëshmive të DT-së nuk ishte përcaktuar si dokument i veçantë dhe i detyrueshëm certifikata e kalibrimit ose raporti teknik.

Në përfundim, Pretendimi nr. 7 është vlerësuar **i bazuar**, pasi pajisja ishte dëshmuar përmes marrëveshjes së shfrytëzimit me përshkrimin përkatës.

### Kundërshtimi i rivlerësimit

AK ka përsëritur arsyen e eliminimit, duke pretenduar mungesën e dëshmisë për kalibrimin dhe gjendjen teknike.

Konsiderojmë se AK ka përdorur përsëri një kërkesë për dokument të veçantë, të cilin eksperti kishte konstatuar se DT-ja nuk e kishte përcaktuar si dëshmi të detyrueshme.

**Kërkojmë** të anulohet arsyeja e eliminimit për pajisjen nr. 1 dhe të respektohet analiza e ekspertit në faqet 43–44 të Vendimit nr. 2026/0613.

**Kërkojmë** të aprovohet ky pretendim si i bazuar.

## PRETENDIMI NR. 7

**– Eliminimi i përsëritur për pajisjen nr. 2, Instrumenti për matjen e temperaturës së asfaltit sipas EN 13108**

## Arsyeja e eliminimit nga AK

AK ka konstatuar se mungon dëshmia se instrumenti për matjen e temperaturës së asfaltit punon sipas standardit EN 13108.

## Konstatimi i ekspertit shqyrtues

Në faqet 44–45 të Vendimit nr. 2026/0613, eksperti ka konstatuar se GOE ka paraqitur marrëveshjen për qiranë e pajisjeve ndërmjet P.M.N. SH.P.K. dhe RICENS SH.P.K.

Në marrëveshje, pajisja nr. 2 është identifikuar shprehimisht si instrument për matjen e temperaturës së asfaltit sipas standardit EN 13108.

Eksperti ka konstatuar se DT-ja nuk ka kërkuar certifikatë të veçantë konformiteti, kalibrimi, raport testimi ose deklaratë të prodhuesit.

Në faqen 45, eksperti ka vlerësuar Pretendimin nr. 8 si **të bazuar**, duke konstatuar se pajisja është paraqitur dhe identifikuar në dokumentacionin e dorëzuar sipas kërkesës së DT-së.

## Kundërshtimi i rivlerësimit

AK ka përsëritur pretendimin për mungesën e dëshmisë së standardit EN 13108, pavarësisht konstatimit individual të ekspertit se marrëveshja e dorëzuar e identifikon pajisjen dhe standardin e kërkuar.

Konsiderojmë se AK nuk ka argumentuar se cili dokument i detyrueshëm, i përcaktuar shprehimisht në DT, ka munguar në ofertë.

**Kërkojmë** të anulohet arsyeja e eliminimit për pajisjen nr. 2 dhe të respektohet konstatimi i ekspertit në faqet 44–45 të Vendimit nr. 2026/0613.

**Kërkojmë** të aprovohet ky pretendim si i bazuar.

## PRETENDIMI NR. 8

## – Eliminimi i përsëritur për pajisjen nr. 4, Kon metalik për testimin e betonit sipas EN 12350-2

## Arsyeja e eliminimit nga AK

AK ka konstatuar se mungon dëshmia që pajisja nr. 4 punon sipas standardit EN 12350-2.

## Konstatimi i ekspertit shqyrtues

Në faqen 45 të Vendimit nr. 2026/0613, eksperti shqyrtues ka konstatuar se grupi ynë ka paraqitur marrëveshjen për shfrytëzimin e pajisjeve me RICENS SH.P.K.

Në marrëveshje, pajisja nr. 4 është identifikuar si kon metalik për testimin e betonit, me standardin EN 12350-2.

Eksperti ka konstatuar se në DT nuk ishte përcaktuar si dëshmi e veçantë certifikata e konformitetit ose raporti i testimit për këtë standard.

Eksperti ka vlerësuar Pretendimin nr. 9 si **të bazuar**, duke konstatuar se eliminimi për mungesën e një dëshmie shtesë nuk mbështetej në kërkesat e DT-së.

## Kundërshtimi i rivlerësimit

AK ka përsëritur të njëjtën arsye eliminimi pa sqaruar se cili dokument konkret, i përcaktuar në DT si dëshmi e detyrueshme, nuk ishte dorëzuar.

Konsiderojmë se ky veprim nuk është arsyetuar në raport me konstatimin individual të ekspertit, të cilit Paneli Shqyrtues i ka dhënë besim të plotë.

**Kërkojmë** të anulohet arsyeja e eliminimit për pajisjen nr. 4 dhe të respektohet konstatimi i ekspertit në faqen 45 të Vendimit nr. 2026/0613.

**Kërkojmë** të aprovohet ky pretendim si i bazuar.

## PRETENDIMI NR. 9

**– Eliminimi i përsëritur për pajisjen nr. 5, Pllaka për testimin e aftësisë mbajtëse sipas EN 13792**

## Arsyeja e eliminimit nga AK

AK ka konstatuar se mungon dëshmia që pajisja nr. 5 punon sipas standardit EN 13792.

## Konstatimi i ekspertit shqyrtues

Në faqet 45–46 të Vendimit nr. 2026/0613, eksperti shqyrtues ka konstatuar se është dorëzuar marrëveshja për qiranë e pajisjeve ndërmjet P.M.N. SH.P.K. dhe G&B-Tampon SH.P.K., datë 10.07.2026.

Në marrëveshje është identifikuar pajisja për testimin e aftësisë mbajtëse të shtresave të konstruksionit të rrugës, me Modulin Dinamik dhe Modulin Statik, sipas standardit EN 13792.

Eksperti ka konstatuar se nga dokumentacioni i shqyrtuar nuk rezulton që DT-ja ka kërkuar certifikatë të veçantë konformiteti, raport testimi ose deklaratë të prodhuesit.

Pretendimi nr. 10 është vlerësuar si **i bazuar**, pasi eksperti ka konsideruar se marrëveshja e shfrytëzimit e identifikon pajisjen me përshkrimin dhe standardin e kërkuar.

## Kundërshtimi i rivlerësimit

AK ka përsëritur arsyen e eliminimit lidhur me mungesën e dëshmisë së standardit EN 13792.

Konsiderojmë se AK nuk ka trajtuar në mënyrë të mjaftueshme analizën e ekspertit, i cili kishte konstatuar se dokumenti i dorëzuar përmbushte mënyrën e dëshmimit të përcaktuar në DT.

**Kërkojmë** të anulohet arsyeja e eliminimit për pajisjen nr. 5 dhe të respektohen konstatimet e ekspertit në faqet 45–46 të Vendimit nr. 2026/0613.

**Kërkojmë** të aprovohet ky pretendim si i bazuar.

## PRETENDIMI NR. 10

**– Eliminimi i përsëritur për pajisjen nr. 7, Instrumenti për matjen e trashësisë së shtresës së ngjyrës**

## Arsyeja e eliminimit nga AK

AK ka konstatuar se mungon dëshmia për përputhshmërinë e pajisjes nr. 7 me standardet ISO 2808, EN ISO 2808 dhe ASTM D 4414.

## Konstatimi i ekspertit shqyrtues

Në faqet 46–47 të Vendimit nr. 2026/0613, eksperti shqyrtues ka analizuar dokumentacionin e pajisjes nr. 7.

Eksperti ka konstatuar se është dorëzuar marrëveshja për qiranë e pajisjeve ndërmjet P.M.N. SH.P.K. dhe I.T.K. SH.P.K.

Në marrëveshje është identifikuar instrumenti për matjen e trashësisë së shtresës së ngjyrës sipas standardeve ISO 2808, EN ISO 2808 dhe ASTM D 4414.

Eksperti ka marrë parasysh edhe dokumentet doganore dhe fotografitë e instrumentit.

Në faqen 47, eksperti ka vlerësuar Pretendimin nr. 11 si **të bazuar**, duke konstatuar se dokumentacioni i dorëzuar e identifikon pajisjen sipas kërkesës së DT-së dhe se certifikata e veçantë e konformitetit nuk ishte përcaktuar si dëshmi e detyrueshme.

## Kundërshtimi i rivlerësimit

AK ka eliminuar përsëri grupin tonë për mungesë të dëshmive të standardeve të kësaj pajisjeje.

Konsiderojmë se AK ka përsëritur një arsye eliminimi të cilën eksperti shqyrtues e kishte analizuar dhe vlerësuar të pabazuar në raport me dokumentacionin dhe kërkesat e DT-së.

Në njoftimin e ri nuk identifikohet në mënyrë të mjaftueshme baza për të mos e ndjekur këtë konstatim.

**Kërkojmë** të anulohet arsyeja e eliminimit për pajisjen nr. 7 dhe të respektohet analiza individuale e ekspertit në faqet 46–47 të Vendimit nr. 2026/0613.

**Kërkojmë** të aprovohet ky pretendim si i bazuar.

**PRETENDIMET ANKIMORE LIDHUR ME OPERATORIN EKONOMIK TË REKOMANDUAR PËR DHËNIE TË KONTRATËS**

## Pretendimi nr. 11

OE i rekomanduar për kontratë **"AL Engineering" sh.p.k. ka dështuar të dorëzojë Listën e stafit për aktivitetin konkret të prokurimit nr. 632-26-4696-2-1-1**.

Dokumenti "Lista e stafit" i dorëzuar nga operatori ekonomik i rekomanduar për kontratë përmban numrin e prokurimit **632-26-4696-2-2-1**, ndërsa aktiviteti objekt i kësaj procedure identifikohet me numrin **632-26-4696-2-1-1.**



"AL Engineering" sh.p.k

| | |
|---|---|
| Për: | KOMUNA E GJAKOVËS |
| Tenderi: | Mbikëqyrja e Projekteve |
| Nr. i prokurimit: | 632-26-4696-2-2-1 |

Lista e stafit

| Nr | Emri dhe Mbiemri | Përgatitja Profesionale | Pozicioni | Përvoja e punës në vite |
|---|---|---|---|---|
| | | Stafi i kompanisë | | |
| 1 | Sami Lokaj | Inxh. Dipl. i Ndërtimtarisë – Drejtimi Konstruktiv | Menaxher i Kontratës Inxhinier/Drejtor Inxhinier i Certifikuar për SSHP | 23 |
| 2 | Nuhi Nuhiu | Master i Ndërtimtarisë – Drejtimi Infrastrukturë Rrugore | Inxhinier Bashkëpunetor Infrastrukturë Rrugore | 8 |
| 3 | Isa Nasufi | Inxh. Dipl. i Arkitekturës | Inxhinier/Arkitekt | 20 |
| 4 | Shkelzen Rexha | Inxh. Dipl. i Ndërtimtarisë – Drejtimi Hidroteknik | Inxhinier Bashkëpunëtor | 20 |
| 5 | Zenel Dinaj | Inxh. Dipl. Elektroteknikës – Drejtimi Sistemet Elektroenergjetike | Inxhinier Bashkëpunëtor | 23 |
| 6 | Avdi Morina | Inxh. Dipl. Elektroteknikës – Drejtimi Elektronikë | Inxhinier i Bashkëpunëtor | 39 |
| 7 | Bekim Tolaj | MSc. i Ndërtimtarisë – Drejtimi Konstruktiv | Inxhinier | 17 |
| 8 | Suad Çmega | Magjister i Gjeodezisë dhe Gjeoinformatikës | Gjeodet Bashkëpunëtor | 12 |

*Vërejtje:* *Lista përmban vetëm një pjesë të stafit që kanë përgatitje profesionale dhe përvojën si projektues të lëmive të kërkuara.*

Prishtinë
13.07.2026

Kompania:
"AL Engineering" sh.p.k

AL ENGINEERING

Kjo mospërputhje dokumentare kërkon verifikim të veçantë nga Autoriteti Kontraktues, me qëllim të konstatimit nëse lista e dorëzuar është përgatitur dhe nënshkruar për aktivitetin konkret të prokurimit apo i referohet një aktiviteti tjetër.

Konsiderojmë se AK nuk mund ta anashkalojë këtë mospërputhje pa vlerësuar përmbajtjen e dokumentit, identifikimin e aktivitetit, angazhimin e personelit dhe plotësimin e kërkesave të Dosjes së Tenderit.

Nëse nga verifikimi rezulton se dokumenti nuk dëshmon angazhimin e stafit për këtë aktivitet, atëherë oferta nuk mund të konsiderohet e përgjegjshme në këtë aspekt.

**Kërkojmë që ky pretendim të aprovohet si i bazuar, të verifikohet përputhshmëria e listës së stafit me aktivitetin konkret dhe të rishqyrtohet përgjegjshmëria e ofertës së operatorit të rekomanduar për kontratë, sipas neneve 59 dhe 69 të LPP-së.**

## Pretendimi nr. 12

## – Shkelja e nenit 59.4 dhe 69 të LPP-së – Mungesa e kontratës së punës për Sami Lokajn

Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenet 59.4 dhe 69 të LPP-së, duke e konsideruar të përgjegjshëm operatorin ekonomik **AL Engineering SH.P.K.**, ndonëse për

Projekt Menaxherin **Sami Lokaj** nuk është dorëzuar kontratë pune apo kontratë mbi vepër, siç është kërkuar në Dosjen e Tenderit.

Vetë operatori ekonomik ka deklaruar se Sami Lokaj është pronar dhe drejtor i kompanisë dhe se për këtë arsye nuk është paraqitur kontrata e punës.

Megjithatë, **Dosja e Tenderit nuk ka paraparë përjashtim nga kjo kërkesë për pronarët apo drejtorët e kompanive**. Statusi i pronarit ose drejtorit nuk e zëvendëson automatikisht dokumentacionin e kërkuar, pa ekzistuar bazë ligjore për një trajtim të tillë.

Konsiderojmë se AK ka zbatuar standarde të ndryshme të vlerësimit të personelit profesional, duke eliminuar grupin tonë për mangësi të pretenduara, ndërsa duke pranuar dokumentacionin e paplotë të operatorit të rekomanduar për kontratë.

**Kërkojmë të aprovohet ky pretendim si i bazuar dhe të verifikohet përmbushja e kriterit për Sami Lokajn. Nëse mungesa e dokumentit të detyrueshëm nuk mund të korrigjohet ligjërisht, kërkojmë që oferta e operatorit të rekomanduar për kontratë të shpallet e papërgjegjshme, në përputhje me nenin 59.4 të LPP-së.**

## Pretendimi nr. 13

Nga dokumentacioni i dorëzuar nga operatori ekonomik i rekomanduar për kontratë rezulton se kontrata e punës e z. Nuhi Nuhiu mban datën 17.03.2026 dhe identifikon aktivitetin “Mbikëqyrja e Projekteve”, me numër të saktë të prokurimit 632-26-4696-2-1-1.

Ndërkohë, Njoftimi për Kontratë për këtë aktivitet është publikuar më 19.06.2026, pra pas datës së shënuar në kontratën e punës.

Kjo mospërputhje kronologjike ngre paqartësi serioze lidhur me datën e hartimit, përmbajtjen fillestare dhe autenticitetin e dokumentit, pasi në të figuron numri i saktë i një aktiviteti të prokurimit përpara publikimit të njoftimit për kontratë.

Konsiderojmë se AK ka qenë i detyruar ta verifikojë këtë mospërputhje përpara se ta konsiderojë dokumentin si dëshmi të vlefshme për përmbushjen e kriterit të stafit profesional.

Për këtë arsye, kërkojmë nga AK të verifikojë kontratën origjinale, datën e nënshkrimit, përmbajtjen fillestare dhe çdo ndryshim eventual të mëvonshëm të saj, si dhe të japë arsyetim se si është vlerësuar kjo dëshmi gjatë procesit të rivlerësimit.

Nëse rezulton se dokumenti nuk është i rregullt ose nuk dëshmon përmbushjen e kriterit të kërkuar, kërkojmë që oferta e operatorit të rekomanduar të vlerësohet në përputhje me nenet 59 dhe 69 të LPP-së.

**Kërkojmë të aprovohet ky pretendim si i bazuar dhe të bëhet verifikimi i plotë i dokumentacionit të paraqitur për Nuhi Nuhiun.**

## Pretendimi nr. 14

Për pozitën e Inxhinierit të Elektroteknikës, AK ka kërkuar minimum **5 vite përvojë pune pas diplomimit në projekte të ngjashme**, e cila duhet të dëshmohet me CV.

Nga CV-ja e z. Zenel Dinaj rezultojnë angazhime profesionale në pozita të ndryshme, përfshirë mbikëqyrje, udhëheqje sektori dhe menaxhim projektesh.

Megjithatë, nga periudhat dhe detyrat e përshkruara në CV nuk rezulton qartë se cilat angazhime konkrete, të realizuara pas diplomimit, përbëjnë përvojë në projekte të ngjashme sipas kërkesës së Dosjes së Tenderit.

Konsiderojmë se AK duhet të vlerësojë natyrën reale të detyrave të kryera, kohëzgjatjen e angazhimeve dhe lidhjen e tyre profesionale me objektin e prokurimit, duke mos i numëruar dy herë periudhat kohore që mbivendosen.

Kërkojmë që AK të arsyetojë konkretisht se si është konstatuar përmbushja e minimumit pesëvjeçar të përvojës në projekte të ngjashme, bazuar në CV-në e dorëzuar.

Nëse pas vlerësimit objektiv rezulton se përvoja e kërkuar nuk është dëshmuar, oferta duhet të trajtohet sipas neneve 59 dhe 69 të LPP-së.

**Kërkojmë të aprovohet ky pretendim si i bazuar.**

## Pretendimi nr. 15

Për pozitën e Inxhinierit të Elektroteknikës, AK ka kërkuar **minimum 5 vite përvojë pune pas diplomimit në projekte të ngjashme**, e dëshmuar përmes CV-së.

Nga CV-ja e z. Avdi Morina rezulton përvojë e gjatë profesionale, mirëpo kohëzgjatja e përgjithshme e përvojës nuk është e mjaftueshme në vetvete për të dëshmuar përmbushjen e kërkesës për minimum pesë vite përvojë pas diplomimit në projekte të ngjashme.

Në dokumentacion janë paraqitur angazhime në menaxhim projektesh, por kërkohet vlerësimi konkret i natyrës së punëve, periudhave të angazhimit dhe përputhshmërisë së tyre me detyrat profesionale të pozitës së kërkuar.

Konsiderojmë se AK duhet të sqarojë se cilat periudha dhe projekte konkrete janë marrë parasysh për të konstatuar përmbushjen e kriterit pesëvjeçar.

Vlerësimi duhet të zbatojë të njëjtin standard për të gjithë tenderuesit, pa interpretuar në mënyrë më kufizuese përvojën e stafit tonë sesa përvojën e stafit të operatorit të rekomanduar për kontratë.

Nëse dokumentacioni i dorëzuar nuk dëshmon përmbushjen e kërkesës, oferta duhet të vlerësohet sipas neneve 59 dhe 69 të LPP-së.

**Kërkojmë të aprovohet ky pretendim si i bazuar.**

## Pretendimi nr.16

**– Nuk është dëshmuar përputhshmëria e termometrit për asfalt me standardin EN 13108**

Në Aneksin 7 të Dosjes së Tenderit, Autoriteti Kontraktues ka kërkuar **instrument/termometër për matjen e temperaturës së asfaltit gjatë procesit të shtruarjes, i cili punon sipas standardit EN 13108**.

Operatori ekonomik i rekomanduar për kontratë **AL Engineering SH.P.K.** ka deklaruar se këtë pajisje e siguron nga N.Sh. "Test & Ing".

Mirëpo, dokumentacioni i dorëzuar përmban fatura për disa lloje termometrash:

- Matës temperature me sondë digjitale;
- Termometër infra të kuq;
- Termometër max/min PVC.

Gjithashtu, në dokumentacionin doganor figurojnë termometra të qelqit për matjen e temperaturës (-30 deri +50°C).

**Në asnjërin prej këtyre dokumenteve nuk identifikohet qartë se cili instrument është ofertuar për përmbushjen e kërkesës së Aneksit 7 dhe nuk evidentohet përputhshmëria e tij me standardin EN 13108.**

Për më tepër, Aneksi 7 përcakton se duhet të bashkëngjiten **certifikatat përkatëse ose dokument tjetër që dëshmon performancën e kërkuar**. Nga dokumentacioni i shqyrtuar nuk rezulton se është paraqitur një dëshmi e tillë për instrumentin konkret.

Rrjedhimisht, dokumentet dëshmojnë posedimin e disa llojeve të termometrave, por **nuk dëshmojnë në mënyrë të qartë përmbushjen e karakteristikës teknike të kërkuar në Dosjen e Tenderit**.

Konsiderojmë se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenet 59.4 dhe 69 të LPP-së, duke e konsideruar të përgjegjshme ofertën pa verifikuar dhe arsyetuar përmbushjen e kësaj kërkese teknike.

**Kërkojmë të aprovohet ky pretendim si i bazuar, të verifikohet përputhshmëria e pajisjes konkrete me kërkesën e Aneksit 7 dhe, nëse konstatohet mospërmbushja e kriterit të detyrueshëm, oferta e operatorit të rekomanduar për kontratë të vlerësohet si e papërgjegjshme.**

## Pretendimi nr.17

**– Mospërputhje ndërmjet çekanit digjital të deklaruar C386N dhe pajisjes së dëshmuar me faturë C386M**

Në Aneksin 7 të Dosjes së Tenderit, operatori ekonomik i rekomanduar për kontratë **AL Engineering SH.P.K.** ka deklaruar pajisjen **MATEST – Model C386N**, për testimin e rezistencës së betonit sipas standardit EN 12504-2, të siguruar nga N.Sh. "Test & Ing".

Edhe manuali teknik i dorëzuar i referohet modelit **Digital Concrete Rebound Hammer C386N**, duke konfirmuar se ky model realizon testime sipas standardit UNI EN 12504-2.

Mirëpo, në **faqen 14 të dokumentacionit të N.Sh. "Test & Ing"**, fatura e blerjes identifikon pajisjen me kodin **C386M**, dhe jo C386N, siç është deklaruar në Aneks dhe në manualin teknik.

Pra, ekziston një mospërputhje e drejtpërdrejtë ndërmjet dokumenteve:

- **Aneksi i pajisjeve:** Model C386N;
- **Manuali teknik:** Model C386N;
- **Fatura e blerjes:** Model C386M.

Kjo mospërputhje nuk mund të konsiderohet automatikisht gabim formal, pasi dokumenti i pronësisë i referohet një modeli tjetër nga ai i deklaruar dhe i mbështetur me dokumentacion teknik.

**Rrjedhimisht, nuk është dëshmuar në mënyrë të qartë se N.Sh. "Test & Ing" posedon pikërisht modelin C386N të deklaruar nga operatori ekonomik**, ndërsa nuk është sqaruar nëse modeli C386M është teknikisht ekuivalent dhe i përmbush kërkesat e Dosjes së Tenderit.

Konsiderojmë se Autoriteti Kontraktues ka qenë i detyruar ta verifikojë këtë mospërputhje përpara se ta konsiderojë ofertën të përgjegjshme, duke zbatuar nenet 59.4 dhe 69 të LPP-së.

**Kërkojmë të aprovohet ky pretendim si i bazuar, të verifikohet përputhshmëria ndërmjet pajisjes së deklaruar, manualit teknik dhe faturës së pronësisë dhe, nëse konstatohet se pajisja e ofertuar nuk është dëshmuar ose nuk i përmbush kërkesat e DT-së, oferta e operatorit të rekomanduar për kontratë të vlerësohet si e papërgjegjshme.**

## Pretendimi nr.18

## Nuk është dëshmuar se Koni i Abramsit i ofruar përmbush standardin EN 12350-2

DT ka kërkuar **kon metalik me pajisjet përcjellëse për testimin e betonit të njomë përmes metodës së konit të Abramsit, i cili punon sipas standardit EN 12350-2**. OE e ka deklaruar këtë pajisje nga N.Sh. "Test & Ing".

Nga dokumentacioni i dorëzuar rezulton se operatori ekonomik ka paraqitur një pajisje të përshkruar si "Konusi për matjen e konsistencës me pajisjet përcjellëse", si dhe faturën për artikullin "SLUMP TEST SETI".

Megjithatë, konsiderojmë se AK duhet të verifikojë nëse pajisja e identifikuar në dokumentet e pronësisë është e njëjta pajisje që është deklaruar në Aneksin 7 dhe nëse ajo posedon karakteristikat teknike të kërkuara.

Theksojmë se kërkesa jonë nuk mbështetet vetëm në mungesën e një certifikate të veçantë, por në nevojën për të verifikuar përputhjen konkrete ndërmjet pajisjes së deklaruar, dëshmive të posedimit dhe specifikimit teknik.

Kërkojmë që AK të arsyetojë se mbi cilat dokumente e ka mbështetur konstatimin se pajisja e ofertuar përmbush kërkesën teknike të përcaktuar në DT.

**Kërkojmë të aprovohet ky pretendim si i bazuar dhe të bëhet verifikimi i përputhshmërisë së pajisjes së ofertuar.**

## Pretendimi nr.19

**Mospërmbushja e kërkesës teknike për Modulin Dinamik dhe Modulin Statik nga pajisja TERRATEST 4000 STREAM**

Në Aneksin 7 të Dosjes së Tenderit, Autoriteti Kontraktues ka kërkuar **"Pllakë për testimin e aftësisë mbajtëse të shtresave të konstruksionit të rrugës (Moduli Dinamik dhe Moduli Statik) sipas standardit EN 13792".**

Operatori ekonomik i rekomanduar për kontratë **AL Engineering SH.P.K.** ka deklaruar pajisjen **TERRATEST 4000 STREAM**, të siguruar nga N.Sh. "Test & Ing".

Nga dokumenti unik doganor rezulton se pajisja e paraqitur është TERRATEST 4000 STREAM, me numër serik 8169, e përshkruar si deflektometër për matjen e ngjeshmërisë së tokës.

Mirëpo, dokumentacioni teknik i prodhuesit e identifikon këtë pajisje si **"Light Weight Deflectometer"**, që funksionon sipas standardeve **ASTM E2835-11 dhe TP BF-StB B8.3**.

Në dokumentacionin teknik bëhet dallim i qartë ndërmjet dy metodave të testimit:

- **Ev2 – Moduli Statik**, sipas standardit DIN 18134;
- **Evd – Moduli Dinamik**, sipas standardit TP BF-StB B8.3.

Nga dokumentacioni i dorëzuar rezulton se TERRATEST 4000 STREAM është pajisje për testime dinamike, ndërsa **nuk është dëshmuar se e realizon edhe testimin statik**, siç kërkohet shprehimisht në Dosjen e Tenderit.

Për më tepër, dokumentacioni teknik i paraqitur nuk identifikon standardin **EN 13792**, por standarde të tjera teknike.

**Rrjedhimisht, dokumentacioni i dorëzuar nuk dëshmon përmbushjen e kërkesës kumulative për Modulin Dinamik dhe Modulin Statik, si dhe përputhshmërinë me standardin e përcaktuar në Aneksin 7.**

Konsiderojmë se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenet 59.4 dhe 69 të LPP-së, duke e konsideruar ofertën të përgjegjshme pa verifikuar dhe arsyetuar përmbushjen e kësaj kërkese teknike.

**Kërkojmë të aprovohet ky pretendim si i bazuar, të verifikohet nëse TERRATEST 4000 STREAM i përmbush të dy funksionet e kërkuara dhe, nëse konstatohet mospërmbushja e specifikimit teknik të detyrueshëm, oferta e operatorit të rekomanduar për kontratë të vlerësohet si e papërgjegjshme.**

## Pretendimi nr.20

**Mospërputhja ndërmjet pajisjes Zehntner ZMM 5000 dhe dokumentacionit teknik të paraqitur për standardet ISO 2808, EN ISO 2808 dhe ASTM D 4414**

Në Aneksin 7 të Dosjes së Tenderit, Autoriteti Kontraktues ka kërkuar **instrument për matjen e trashësisë së shtresës së ngjyrës sipas standardeve ISO 2808, EN ISO 2808 dhe ASTM D 4414**.

Operatori ekonomik i rekomanduar për kontratë **AL Engineering SH.P.K.** ka deklaruar pajisjen **Zehntner ZMM 5000**, në pronësi të Traffiks VA.

Nga fatura e dorëzuar rezulton se pajisja e blerë është **"Instrument për matjen e trashësisë së ngjyrës Zehntner, ZMM 5000"**. Gjithashtu, në faqet 22–23 të dokumentacionit teknik është paraqitur manuali për modelin ZMM 5000.

Mirëpo, dokumenti në të cilin figurojnë standardet **ISO 2808, EN ISO 2808 dhe ASTM D 4414** nuk i referohet modelit ZMM 5000, por një serie tjetër pajisjesh, përkatësisht **"ZND 2050–2054 Instruction Manual"**.

Pra, ekziston një mospërputhje e drejtpërdrejtë ndërmjet dokumenteve:

- **Pajisja e deklaruar dhe e dëshmuar me faturë:** Zehntner ZMM 5000;
- **Dokumenti teknik që përmban standardet e kërkuara:** ZND 2050–2054.

Konsiderojmë se **dokumentacioni teknik i një modeli tjetër nuk mund të përdoret automatikisht për të dëshmuar përputhshmërinë e pajisjes ZMM 5000 me standardet e kërkuara në Dosjen e Tenderit**, pa u verifikuar zbatueshmëria e tij për modelin konkret.

Nga dokumentacioni i paraqitur nuk rezulton qartë se pajisja ZMM 5000 i përmbush standardet ISO 2808, EN ISO 2808 dhe ASTM D 4414.

**Rrjedhimisht, nuk është dëshmuar në mënyrë të qartë përputhshmëria teknike e pajisjes konkrete të ofertuar me kërkesat e Aneksit 7.**

Konsiderojmë se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenet 59.4 dhe 69 të LPP-së, duke e konsideruar ofertën të përgjegjshme pa verifikuar dhe arsyetuar këtë mospërputhje dokumentare.

**Kërkojmë të aprovohet ky pretendim si i bazuar, të verifikohet dokumentacioni teknik i modelit Zehntner ZMM 5000 dhe, nëse konstatohet se pajisja nuk i përmbush kërkesat teknike të detyrueshme të Dosjes së Tenderit, oferta e operatorit të rekomanduar për kontratë të vlerësohet si e papërgjegjshme.**

**KUNDËRSHTIMI I VENDIMIT TË AUTORITETIT KONTRAKTUES TË DATËS 16.11.2026**

Autoriteti Kontraktues – Komuna e Gjakovës, me Vendimin e datës 16.11.2026, e ka refuzuar si të pabazuar kërkesën tonë për rishqyrtim të datës 13.11.2026, e ka vërtetuar Njoftimin mbi Vendimin e datës 09.11.2026 dhe ka vendosur që aktiviteti i prokurimit të vazhdojë.

Këtë vendim e kundërshtojmë në tërësi për këto arsye:

**1. AK nuk e ka shqyrtuar asnjë pretendim të kërkesës për rishqyrtim**

Në kërkesën për rishqyrtim kemi paraqitur pretendime konkrete për arkitektin Driton Kabashi, inxhinierin elektrik Lulzim Halitaj, gjeodetët Luan Abazi dhe Agron Shabani, pajisjet nr. 1, 2, 4, 5 dhe 7, si dhe për ofertën e OE të rekomanduar AL Engineering SH.P.K.

AK nuk ka shqyrtuar asnjërin prej tyre. Vendimi nuk përmban asnjë analizë dhe asnjë përgjigje për pretendimet tona. AK është kufizuar vetëm në citimin e një fjalie nga faqja 47 e Vendimit të OSHP-së nr. 2026/0613.

Një vendim i tillë nuk mund të konsiderohet vendim i arsyetuar sipas nenit 108/A të LPP-së dhe nenit 63 të Rregullores për Prokurim Publik.

**2. AK e ka shfrytëzuar një gabim teknik në konkluzionin e ekspertit dhe e ka shpërfillur përmbajtjen e vërtetë të vendimit të OSHP-së**

Fjalia që citon AK nga faqja 47, sipas së cilës "Pretendimet nr. 2 deri nr. 11 vlerësohen si TË PABAZUARA", është gabim teknik i dukshëm. Këtë e dëshmon vetë Vendimi i OSHP-së nr. 2026/0613:

- Në faqet 37–47 eksperti shqyrtues i ka analizuar veçmas Pretendimet nr. 2 deri nr. 11 dhe secilin e ka vlerësuar si **I BAZUAR**, duke konstatuar se "eliminimi i ofertës për këtë arsye konsiderohet i pabazuar". Kjo vlen për arkitektin Driton Kabashi, inxhinierin elektrik Lulzim Halitaj, gjeodetët Luan Abazi dhe Agron Shabani, si dhe për pajisjet nr. 1, 2, 4, 5 dhe 7.
- Në të njëjtën faqe 47, menjëherë pas fjalisë së cituar, eksperti rekomandon: "APROVIMI I ANKESËS, ANULIMI I VENDIMIT TË AK-së DHE KTHIMI I LËNDËS NË RI-VLERËSIM". Ky rekomandim nuk do të kishte asnjë kuptim nëse 10 nga 11 pretendime do të ishin të pabazuara.
- Në faqen 48, Paneli Shqyrtues i ka dhënë "besimin e plotë konstatimeve të ekspertit shqyrtues", e ka aprovuar ankesën tonë si të bazuar dhe ka konstatuar se AK "nuk ka vepruar në përputhje me dispozitat ligjore", duke e urdhëruar që gjatë rivlerësimit "t'i përmbahet në tërësi dispozitave ligjore të LPP-së".

AK ka zgjedhur ta citojë vetëm këtë fjali të gabuar dhe ta shpërfillë gjithë analizën e ekspertit, rekomandimin e tij dhe vendimin e Panelit Shqyrtues. Ky veprim nuk është në përputhje me detyrimin e AK-së për të zbatuar vendimin e OSHP-së sipas nenit 117 të LPP-së.

**3. AK e mbron vendimin e ri me konstatime që i përkasin vendimit të vjetër**

Vendimi i OSHP-së nr. 2026/0613 i referohet Njoftimit mbi Vendimin e datës 31.07.2026, i cili tashmë është anuluar.

Kërkesa jonë për rishqyrtim ishte kundër Njoftimit të ri mbi Vendimin e datës 09.11.2026. Ky është akt i ri dhe duhet të ketë arsyetimin e vet të plotë. AK nuk ka dhënë asnjë arsyetim pse, pas rivlerësimit, ka përsëritur të njëjtat arsye eliminimi që eksperti shqyrtues i kishte vlerësuar si të pabazuara.

**4. AK nuk ka trajtuar asnjë pretendim lidhur me OE të rekomanduar AL Engineering SH.P.K.**

AK ka heshtur plotësisht për pretendimet tona lidhur me ofertën e OE të rekomanduar:

- Lista e stafit mban numrin e prokurimit 632-26-4696-2-2-1 dhe jo numrin e këtij aktiviteti, 632-26-4696-2-1-1.
- Për Projekt Menaxherin Sami Lokaj nuk është dorëzuar kontratë pune apo kontratë mbi vepër, siç kërkohet në Dosjen e Tenderit.
- Kontrata e punës e z. Nuhi Nuhiu mban datën 17.03.2026 dhe numrin e saktë të këtij aktiviteti, ndërsa Njoftimi për Kontratë është publikuar më 19.06.2026.
- Nuk është arsyetuar përmbushja e përvojës minimale pesëvjeçare për z. Zenel Dinaj dhe z. Avdi Morina.
- Nuk është dëshmuar përputhshmëria e termometrit për asfalt me standardin EN 13108
- Mospërputhje ndërmjet çekanit digjital të deklaruar C386N dhe pajisjes së dëshmuar me faturë C386M
- Nuk është dëshmuar se Koni i Abramsit i ofruar përmbush standardin EN 12350-2
- Mospërmbushja e kërkesës teknike për Modulin Dinamik dhe Modulin Statik nga pajisja TERRATEST 4000 STREAM
- Mospërputhja ndërmjet pajisjes Zehntner ZMM 5000 dhe dokumentacionit teknik të paraqitur për standardet ISO 2808, EN ISO 2808 dhe ASTM D 4414.

Me këtë veprim AK ka zbatuar standarde të ndryshme vlerësimi: grupin tonë e ka eliminuar për mangësi të pretenduara, ndërsa ofertën e OE të rekomanduar e ka pranuar pa i verifikuar mospërputhjet e dukshme. Ky trajtim bie ndesh me parimin e barazisë së trajtimit dhe mosdiskriminimit sipas nenit 7 të LPP-së.

**5. Mosarsyetimi i eliminimit të ofertës më të lirë**

Kriteri për dhënien e kontratës është “Tenderi i përgjegjshëm me çmimin më të ulët”. Oferta e grupit tonë është 89.400,00 €, ndërsa oferta e OE të rekomanduar është 115.500,00 €, pra oferta jonë është 26.100,00 € më e ulët.

Duke e eliminuar këtë ofertë pa arsyetim të mjaftueshëm, AK cenon parimin e ekonomisë dhe efikasitetit në shfrytëzimin e fondeve publike sipas nenit 6 të LPP-së.

I. Të aprovohet si e bazuar ankesa e **GOE P.M.N. SH.P.K. & N.P.N. UNIVERS-MI,** për aktivitetin "Mbikëqyrja e Projekteve", nr. 632-26-4696-2-1-1.

II. Të anulohet Vendimi i AK-së i datës 16.11.2026 dhe Njoftimi mbi Vendimin B58 i datës 09.11.2026.

III. Të anulohen arsyet e eliminimit të grupit tonë, në përputhje me konstatimet e ekspertit dhe vendimin e Panelit në Vendimin e OSHP-së nr. 2026/0613.

IV. Aktiviteti të kthehet në rivlerësim, me urdhër që AK ta respektojë plotësisht Vendimin e OSHP-së nr. 2026/0613 dhe t'i verifikojë pretendimet tona ndaj OE të rekomanduar AL-Engineering SH.P.K.

V. Të shqyrtohet mosrespektimi i Vendimit të OSHP-së nr. 2026/0613 nga AK, sipas nenit 131 të LPP-së.

**9. Dëmet materiale**

*Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.*

| |
|---|
| Dëmet materiale që na shkaktohen janë të konsiderueshme si në fushën financiare, fitime të munguara-humbura, shpenzime përgatitore në aspektin teknik për kontratë NE VLERE PREJ 4500 EURO. Po ashtu kemi edhe dëmtim të reputacionit si një kompani serioze, dhe me një përvojë të madhe në fushën e ngjashme. |
| |

**10. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura**

Ne i kemi bashkangjitur Ankesës tonë dokumentet e renditura më poshtë:

- Një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë"
- Një kopje të publikimit për "Njoftimi mbi Vendimin e AK"
-

Vërejtje: Të gjitha pretendimet tona mbështeten me fakte që i gjeni të bashkangjitura kësaj ankese por edhe në dokumentacionin e AK

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*